**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LUSHNJË**

**Nr.** 3627 **Prot.** **Lushnjë, më** 16/04/**2026**

**R E L A C I O N**
**KËSHILLIT BASHKIAK**
**KËTU**

**"PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT KRYETARIT TË BASHKISË PËR TË PËRFAQËSUAR BASHKINË LUSHNJË NË KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR (SHBB)"**

*Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë !*

Në kuadër të zhvillimit rural dhe mbështetjes së fermerëve të sektorit të ullirit në territorin e Bashkisë Lushnjë, është propozuar krijimi i një Shoqërie të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) me objekt prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e përbashkët të vajit të ullirit. Shoqëria do të krijohet duke iu përmbajtur dispozitave ligjore të Ligjit nr.38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor".

Kjo nismë synon bashkimin e prodhuesve lokalë për të arritur përfitime ekonomike konkrete: blerje kolektive inputesh, tregtim i përbashkët me çmime më të larta, certifikim cilësie, akses në grante IPARD dhe programe kombëtare, si dhe forcim i pozicionit në tregun vendor e ndërkombëtar.

Bashkia Lushnjë, referuar pikës 3, të nenit 27, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, do të jetë në rolin e këshilluesit, me qëllim ofrimin e mbështetjes së plotë në ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Bashkia ka asistuar në hartimin e draft-akt themelimit dhe draft-statutit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor.

SHBB do të bashkëpunojë ngushtë me Bashkinë për asistencë teknike, organizim takimesh, dhënie hapësirash publike, lehtësim procedurash dhe asistencë për certifikimin e produktit nga organet kompetente.

Për të formalizuar dhe garantuar këtë bashkëpunim, është e nevojshme që Këshilli Bashkiak të autorizojë Kryetarin e Bashkisë të përfaqësojë Bashkinë Lushnjë në të gjitha fazat e

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LUSHNJË**

**Nr.** 3627 **Prot.** **Lushnjë, më** 16.04 **.2026**

**PROJEKT - V E N D I M**
**NR.** 40 **DATË** 16.04 **. 2026**

**"PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT KRYETARIT TË BASHKISË PËR TË PËRFAQËSUAR BASHKINË LUSHNJË NË KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR (SHBB)"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____.___.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Bashkia në mbështetje të nenit 111 pika 1, neni 112 pika 2, neni 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Neni 8 pika 1 e 2 neni 9 pika 1.1 shkronja"a",pika 1.6 shkronja " d " neni 27, neni 64 shkronja "b" të ligjit nr.135/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar. Neni 2 pika 2 shkronja"c", neni 4, neni 34 pika 1, neni 107, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë". Ligjit nr.38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor". Neni 19 shkronja "c" , neni 30 të ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural". Neni 5 të ligjit nr.36/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit".VKM-së nr.205 datë 30.03.2026 "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2026" ju

**PROPOZOJMË:**

1. Dhënien e autorizimit Kryetarit të Bashkisë për të përfaqësuar Bashkinë Lushnjë në krijimin dhe funksionimin e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor (SHBB).
2. Për zbatimin e këtij vendimi autorizohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas zbardhjes.

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

**KRYETARI I BASHKISË**
**ERISELDA SEFA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJË

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

krijimit dhe funksionimit të SHBB-së, duke përfshirë nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, protokolleve, dhënien e mbështetjes administrative dhe çdo veprim tjetër brenda kompetencave ligjore të bashkisë

Bashkëlidhur këtij relacioni do të gjeni Draft-Akt Themelimin dhe Draft- Statutin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor.

**KRYETAR I BASHKISË**
**Eriselda SEFA**

